

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)

BULETINI INFORMATIV NR. 3

JANAR - MARS 2022

Pas lançimit zyrtar të **Programit për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)** në datë 1 prill, 2021, DCAF vazhdoi me implementim konsistent të aktiviteteve të parapara. Me zbutjen graduale të masave kundër COVID-it aktivitetet me pjesëmarrje fizike fatmirësisht po rikthehen, ashtu siç kanë qenë para periudhës COVID.

Periudhën janar-mars 2022 e shënuan një sërë aktiviteteve që synojnë ndërtimin e një sektori sigurie dhe të zbulimit llogaridhënës që qeveriset në mënyrë më efektive. Gjatë kësaj periudhe, Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë në Shkup thirri **takimin e parë të Grupit Drejtues nga Gjyqësori (në 25 shkurt 2022)** – organ themeluar me Marrëveshjen për Bashkëpunim mes DCAF-it dhe Akademisë brenda këtij Programi. Në këtë grup bëhen bashkë përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor, Këshillit të Prokurorëve, Shoqatës së Gjykatësve dhe Shoqatës së Prokurorëve për të vlerësuar rregullisht dhe për të udhëzuar zbatimin e këtij Programi, duke u siguruar që komplementohen dhe nxiten reformat në vend. Ky këmbim i rregullt i informacionit rrit cilësinë e këmbimit

DCAF dhe R/QQS

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë angazhohet për rritje të cilësisë së sigurisë së vendeve dhe popujve në ato vende brenda qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit, respektit ndaj të drejtave të njeriut, dhe barazisë gjinore. Që nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar duke rritur qëndrueshmërinë e paqes dhe zhvillimit përmes ndihmës ofruar shteteve partnere, dhe përmes mbështetjes që palët ndërkombëtare u ofrojnë këtyre shteteve për të rritur cilësinë e qeverisjes në sektorin e sigurisë me reforma gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje të të gjitha palëve. DCAF harton materiale njohurie që janë inovative, promovon normat dhe praktikën e mira, ofron këshilla ligjore dhe të politikbërjes dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve që veprojnë në fushën e sigurisë- qofshin ato shtetërore apo jo. DCAF është një nga organizatat kryesore në botë në fushën e qeverisjes me sektorin e sigurisë (QSS) dhe reformat në sektorin e sigurisë (RSS).

Arritjet kryesore dhe kontributi i DCAF-it mund të shihen në [videon](#) më të re.

të informatave dhe ekspertizës duke kontribuar drejt forcimit të kompetencave gjyqësore dhe kapaciteteve në fushën e autorizimit dhe shqyrtimit të kërkesave për metodat ndërhyrëse për mbledhje të informatave, duke forcuar kështu pavarësinë e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.





Vlerësim Ekspertësh në Terren
Shkup, 18-19 janar 2022

REZULTATI I

Programi i DCAF-it për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë poashtu mbështet edhe Ministrinë e Brendshme. Në këtë drejtim, në **18-19 janar, 2022** në Shkup u mbajt **Vlerësim Ekspertësh në Terren mbi Procesimin dhe Këmbimin e Automatizuar të ADN-së**. Ekspertë ndërkombëtarë nga INTERPOL-i dhe nga Policia e Sllovenisë bënë vlerësim të aspekteve normative, organizative, praktike, dhe teknike që kanë të bëjnë me procesimin dhe këmbimin e automatizuar biometrik (ADN) të të dhënave dhe propozuan rekomandime për Konventën e Prum-it dhe të Bashkëpunimit Policor – gatishmëria e Rrjetit të Evropës Juglindore për Bazën e të Dhënave për këmbim ndërkombëtar online të të dhënave të ADN-së. Pjesë e këtij vlerësimi ishte edhe kontrolli i amandamenteve që propozohen për ligjet momentale dhe për procedurat ndërkombëtare për këmbim të të dhënave të ADN-së. Poashtu, u bë edhe vlerësimi i udhëheqjes së bazave kombëtare të të dhënave të ADN-së dhe zgjidhjeve të parapara softuerike për këmbim ndërkombëtar të të dhënave të ADN-së. DCAF do të mbështesë Grupin Punues nga MPB-ja gjatë procesit të hartimit të një strategjie dhe plani veprimi mbi zgjidhjen e zbrazëtirave të identifikuara.

Programi për Reforma në Sektorin e Zbulimit dhe Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Prill 2021 - Mars 2026

Në vazhden e arritjeve të fundit, qëllimi i këtij Programi është të vijojë me procesin e reformave demokratike në sektorin e sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Strategjia e intervenimit ka për qëllim të sigurojë që shërbimet e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut funksionojnë siç duhet nën kontrollin dhe mbikëqyrjen aktive demokratike duke luftuar kundër krimeve serioze të organizuara dhe duke frenuar korrupsionin në përputhje me praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Ky Program është i strukturuar për të arritur tre rezultate:

Rezultati I: Ndryshim dhe plotësim i kornizave ligjore dhe institucionale në sektorin e zbulimit në Maqedoninë e Veriut në përputhje me parimet relevante Euro-Atlantike dhe praktikën e mira të llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Rezultati II: Organe të mbikëqyrjes së jashtme dhe kontrollit fitojnë njohuri dhe forcojnë kapacitetet për të zbatuar mbikëqyrje transparente dhe efektive të aktiviteteve që bën sektori i zbulimit.

Rezultati III: Opinioni informohet lidhur me funksionalitetin dhe rezultatet e sistemit të llogaridhënies së sigurisë dhe zbulimit.

Partnerët për zhvillim: Holanda (Ministria e Punëve të Jashtme), Suedia (Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim - Sida), Zvicra (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim -SDC) dhe Bashkimi Evropian.

Partnerët në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Kuvendi i Maqedonisë së Veriut
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Mbrojtjes
- Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit
- Agjencia Teknike Operative (ATO)
- Agjencia për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara
- Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
- Zyra e Prokurorit Publik kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
- Gjykata dhe institucione të tjera gjyqësore
- Avokati i Popullit
- Revizioni i Shtetit
- OJQ-të dhe mediet



Punëtorja mbi Rregulloren e punës (RRP) për Përdorim të Dhomës së Izoluar dhe Vendit të Mbrojtur të Punës
Shkup, 21 janar 2022

REZULTATI II

DCAF mbështet Kuvendin për krijim të një Dhome të Izoluar dhe hapësire të mbrojtur pune për manovrim me informatat e klasifikuara. Nga fillimi i muajit prill Kuvendi është aktivizuar për përfundim të tenderit të tretë publik për pjesën ndërtimore të këtij procesi. Njëkohësisht, DCAF me ekspertët e vendit po mundëson proces që udhëhiqet nga vetë ekspertët në vend për hartim të Procedurave Standarde të Veprimit për përdorim të sigurt dhe efektiv të Dhomës së Izoluar dhe hapësirës së mbrojtur të punës brenda në Kuvend. Për këtë qëllim, u organizuan **katër punëtori (21 janar, 18 shkurt, 18 dhe 22 mars, 2022)**. I tërë procesi udhëhiqet nga përfaqësues të Drejtorisë për Siguri të Informatave të Klasifikuara dhe përfaqësues të MPB-së që merren me Sigurinë në Kuvend, me ndihmë nga stafi i Kuvendit dhe me mbështetje nga DCAF. Ky proces është mjaft interaktiv dhe puna udhëhiqet nga vetë ekspertët e vendit. Planifikohen edhe punëtori të tjera për tremujorin e ardhshëm për të finalizuar dokumentin.

Gjatë **3-4 shkurtit, 2022** u organizua punëtori praktike për deputetët dhe stafin që shërbejnë në komisionet e kuvendit për mbikëqyrje të sigurisë dhe zbulimit. Ngjarja me titull **“Analiza e zbrazëtirave në zbatimin e dispozitave të Ligjit për ndjekje të komunikimeve**

(LNK) dhe Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (ATO) dhe diskutim mbi rritjen e cilësisë së ligjeve në sektorin e sigurisë” u mbajt në Veles, Maqedoni e Veriut. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte stimulimi i debatit dhe reflektimeve mbi qasjet dhe zgjidhjet e mundshme për të ashtuquajturat pengesa në zbatim dhe dobësitë që bëjnë që këto ligje të jenë joefektive dhe joefikase në disa fusha. Qasja që zbatoi punëtorja përfshinte njohuri nga ekspertët si nga fusha e akademisë ashtu edhe nga personat që praktikojnë punën në fushën e sigurisë-zbulimit. Përfundimi i përgjithshëm që u arrit gjatë kësaj punëtorie ishte që ekziston nevoja për rritje të cilësisë së ligjeve dhe pjesa më e madhe e anëtarëve ranë dakord që zgjidhja më e mirë do të ishte një ligj i posaçëm për mbikëqyrje të zbulimit. Deputetët pjesëmarrës theksuan që si përfaqësues të institucionit më të lartë demokratik, janë ata që duhet të përpiqen më shumë brenda grupeve parlamentare për të inicuar ndryshimet dhe apo përmirësimet e ligjeve ekzisutese.

Në **22 shkurt 2022** në Shkup u mbajt **Punëtori për Mbrojtje të Informatorëve**. Pjesëmarrësit nga Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut, më saktë nga Sektori për Kontroll të Brendshëm, Hetime Penale, dhe Standarde Profesionale, diskutuan mbi praktikën e mira, ligjet e vendit, politikën, dhe iniciativat që kanë të bëjnë me informimin dhe mbrojtjen e informatorëve brenda agjencive që zbatojnë ligjin. Këto diskutime



u mbështetën nga ekspertë të jashtëm që veprojnë në vend nga organizatat ndërkombëtare (GRECO), iniciativat rajonale (RAI), institucionet e vendit (Ministra e Drejtësisë, Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit) dhe fusha e akademisë (Fakulteti i Sigurisë - Shkup). Përmes kësaj punëtorie pjesëmarrësit fituan më shumë njohuri mbi konceptin dhe mekanizmat e mbrojtjes së informatorëve dhe mënyrave më të mira për të rritur kapacitetet për të forcuar mbrojtjen e informatorëve.

Gjatë kësaj periudhe, DCAF vazhdoi me përkthim në gjuhën maqedone dhe shqipe të Përmbledhjeve Tematike që janë hartuar për të ndërtuar kapacitetet e shërbimeve të zbulimit dhe stafit mbikëqyrës, në mënyrë që të bëjnë ato më të qasshme për sektorin e zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Përveç disa botimeve të përkthyera si **“Roli i Kuvendit në Mbikëqyrjen e Detyrave të Zbulimit”** dhe **“Prokurimet e Zbulimit”**, DCAF bëri përkthimin dhe shpërndarjen e dy përmbledhjeve të tjera tematike: **“Kontrolli i brendshëm i shërbimeve të zbulimit”** (që shqyrton kontrollin e brendshëm në shërbimet e zbulimit duke iu referuar zonës Euro-atlantike) dhe **“Rikonceptimi i angazhimit mes shërbimeve të zbulimit dhe shoqërisë civile”** (me synim që shërbimet e zbulimit dhe shoqëria civile të njihen më mirë me konceptin e mbikëqyrjes demokratike/zyrtetare dhe modalitetet e bashkëpunimit).

Mekanizmi i Partnerëve Zhvillimorë për Udhëheqje

Për këtë program u zgjodh mekanizmi i financimit të përbashkët dhe deri në dhjetor 2021 kanë kontribuar katër Partnerë Zhvillimorë. Këta janë Holanda (CHF 780'000), Suedia (rreth CHF 960'000), Zvicra (CHF 1'000'000), dhe Bashkimi Evropian (rreth CHF 320'000). Bashkë me kontributin vetanak të DCAF-it dhe mbështetjen e mjete jofinanciare nga partnerët përfitues, pra me sigurimin e zgrave, vendtakimeve, pajisjeve teknike, transportin lokal, dhe ekspertët, buxheti i përgjithshëm për periudhën 2021-2026 arrin CHF 4'939'219.

Ky Program udhëhiqet nga grupi i Komisioneve Udhëheqëse me partnerë të vendit përfitues dhe nga Grupi Udhëheqës i Partnerëve Zhvillimorë (GUPZH). GUPZH përbëhet nga Ambasadorët dhe ekipi i programit i nivelit të lartë. Ata angazhohen në mënyrë aktive me Programin duke ofruar këshilla politike dhe strategjike, këshilla për zbutje të rreziqeve dhe efektivitet në zbatim. Takimet e GUPZH mbahen një herë në tre muaj dhe organizohen nga misionet e Partnerëve Zhvillimorë me rotacion.

Edhe pse hartuar nga programe të tjera brenda DCAF-it ky program përfiton mjaft nga njohuria e theksuar menaxheriale e brendshme e DCAF-it, që siguron bartje efektive të njohurive.

Për sa i përket forcimit të gjyqësorit, DCAF vazhdoi me realizim të **punëtorive për Trajnim të Trajnerëve (TT)** mbi shtrirjen dhe shpërndarjen për praktikuesit e shërbimeve gjyqësore dhe ligjore, me titull **“Nga teoria në praktikë: Avancimi i praktikave gjyqësore mbi mbikëqyrjen e Masave të Posaçme Hetimore (MPH) me përdorim të Metodave për Nxënie dhe Ruajtje të Njohurive”**.



Baza e këtyre punëtorive është **Doracak** botuar para ca kohëve kurse qëllimi është forcimi i kapaciteteve të praktikuesve të shërbimeve gjyqësore për të mbështetur seancat trajnuese, në përputhje me parimet transformative dhe aktive të mësimit tek të rriturit. Punëtorja e tretë TT u mbajt nga 2-4 mars 2022 në Mavrovë. Ofrimi i punëtorive gjysëm ditore për shtrirje dhe shpërndarje pas çdo punëtorie TT bën të mundur që pjesëmarrësit të “vënë në përdorim” atë që kanë mësuar nga punëtorja para një publiku live të praktikuesve të shërbimeve ligjore. Trajnerët përfitojnë nga secila punëtori TT duke forcuar aftësitë e tyre për të udhëhequr, duke përfshirë ushtrime interaktive dhe angazhim të një audienceje të synuar. Me zhvillim të këtyre aftësive, trajnerët kanë bërë përparim të madh në riprodhimin dhe bartjen e njohurive brenda një mjedisi mësimor tek të rriturit, si dhe kanë angazhuar audiencën në mënyrë praktike dhe interaktive.

DCAF poashtu vepron në forcimin e barazisë gjinore në institucionet e sektorit të sigurisë në Maqedoninë e Veriut. Në këtë drejtim, DCAF-i zhvillon dialog të afërt për zbatim të **Procesit të Vetë-vlerësimit Gjinor (VVGJ) brenda Ministrisë së Mbrojtjes (MM)** me përfaqësues relevantë nga Sektori i MM për Mundësi të Barabarta. Ky parashihet si proces që udhëhiqet nga vetë vendi me një sërë aktivitete (duke përfshirë qasjet kuantitative dhe kualitative) ndërtuar për të vlerësuar gatishmërinë për barazi gjinore në Ministri (përfshirë këtu edhe Ushtrinë),

në veçanti lidhur me atë se struktura, proceset dhe kultura institucionale a plotësojnë nevojat e veçanta të burrave, grave dhe pakicave gjinore. Pasi të jetë zbatuar, produktet përfundimtare (raporti GSA dhe plani i veprimit që bazohet në prova) priten të integrohen si pjesë plotësuese e aktiviteteve të ardhme gjinore brenda institucionit dhe do të ofrojnë tregues dhe udhëzues të qartë për zbatim më të mirë të stragjive dhe planeve gjinore.

REZULTATI III

Për të arritur rritjen e besimit nga opinioni, DCAF vazhdon bashkëpunimin aktiv me OJQ lokale dhe partnerë nga mediet në Maqedoninë e Veriut, për të ndihmuar forcimin e debatit publik dhe besimin tek palët e sektorit të sigurisë. Në këtë drejtim, DCAF filloi bashkëpunim oficial me dy OJQ, [EUROTHINK](#) dhe [C3Initiative](#).

EUROTHINK do të fokusohet në analizë krahasuese dhe matricë transparence për të identifikuar praktikat më të mira të shërbimeve të zbulimit nga MB dhe Sllovenia dhe për të rritur vetëdijen në Maqedoninë e Veriut. Intervenimi me titull **“Përmirësimi i strategjive për komunikim me publikun tek palët e sektorit të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut”** do të përmbyllet me 3 Diskutime Eurotalks (strukturuar sipas Rregullave Chatham House). Përmes këtij intervenimi do të kërkohet shpjegimi i ngjashmërive dhe dallimeve mes





**Pamje nga mini-dokumentari “Mbikëqyrja qytetare dhe demokratike
e sektorit të zbulimit dhe sigurisë”, janar 2022**

360

**Our interlocutors say that informal oversight
is a feature of advanced democracies.**

tri vendeve dhe hartimi i një kornize analitike bashkë me rekomandime për përmirësim për Maqedoninë e Veriut.

Intervenimi i C3Initiative me titull **“Forcimi i reformave në sektorin e zbulimit përmes analizës së sistemit aktiv dhe reflektimeve të më shumë palëve relevante”** synon të plotësojë zbrazëtirat dhe të shtojë vlerat kontribuese duke zbatuar metoda unike të strukturuar të analizës së sistemit aktiv dhe të më shumë palëve relevante (përmes teknikave të analizës kualitative dhe teknikave të grupit nominal), dhe të ofrojë rekomandime konkrete, si dhe udhëzues me tregues, për rritje të transparencës dhe llogaridhënies tek palët e sektorit të zbulimit dhe sigurisë. Poashtu, do të tentojë të rrisë besimin tek palët relevante dhe të përballet me çështje përmes zgjidhjes konstruktive të problemeve dhe diskutimeve bashkëpunuese me këmbim idesh.

DCAF do të vazhdojë rolin aktiv në zbatimin e intervenimeve individuale me mentorim, rekomandime, kapacitete për organizim takimesh dhe inkurajim të

bashkëpunimit mes partnerëve nga OJQ-të dhe sektorit të zbulimit dhe sigurisë. Në këtë drejtim u organizua **Sesioni i Përbashkët mes partnerëve nga OJQ-të dhe përfaqësuesve relevantë nga shërbimet e zbulimit dhe sigurisë** në datën **17 mars 2022** në Shkup. Qëllimi i takimit ishte të sigurohet transparencë dhe pronësi lokale me shpjegim dhe përfshirje të shërbimeve relevante të sigurisë të intervenimeve të planifikuara nga OJQ-të që bashkëfinancohen nga DCAF. Poashtu u asistua edhe në lehtësim të ndërtimit të rrjeteve dhe forcimit të besimit mes OJQ-ve dhe palëve nga sektoret e zbulimit dhe sigurisë.

Për sa i përket ndërtimit të besimit dhe rritjes së dukshmërisë të progresit dhe reformave në sektoret e zbulimit dhe sigurisë, DCAF në bashkëpunim me Median 360 Shkallë solli në jetë dy **storje të tjera audio-vizuele në formë mini-dokumentari** (kombinim i tregimit të historisë dhe përmbajtjes informative për rritje të vetëdijes) që u transmetuan në stacionin televiziv kombëtar ALSAT. Storja mini-dokumentar



Pamje nga mini-dokumentari "Siguria e informatave të klasifikuara"
mars, 2022

360



But I absolutely justify and support the need
for special regulation of their position in the system

"Mbikëqyrja civile dhe demokratike e sektoreve të zbulimit dhe sigurisë" (transmetuar në **Janar 2022**)

theksoi rëndësinë e palëve të pavarura (OJQ, think-tanks, komuniteti akademik, dhe media) dhe angazhimin e tyre në aktivitete joformale për mbikëqyrje të sektorit të sigurisë. Këto palë të pavarura, përveç komplementimit të punës së institucioneve që janë përgjegjëse për mbikëqyrjen oficiale të sektoreve të zbulimit dhe sigurisë, përbëjnë poashtu edhe lidhje mes institucioneve oficiale të sigurisë, politikave dhe proceseve, dhe realiteteve dhe nevojave të vendit. Qëllimi është që të sigurohet përfshirje e interesave dhe perspektivave të opinionit të gjerë, por edhe mbështetje më e madhe nga institucionet për reformim dhe demokratizim të sektoreve të zbulimit dhe sigurisë, në mënyrë që të rritet cilësia e praktikave dhe dispozitave të sigurisë.

Storja e tretë mini-dokumentar **"Siguria e informatave të klasifikuara"** u transmetua në **mars 2022** dhe kishte të bëjë me rolin, statusin, dhe nevojën për reforma në Drejtorinë e Sigurisë së Informatave të Klasifikuara (DSIK), sidomos në pengimin e rrjedhës së burimeve njerëzore dhe prezantimin e politikave të duhura të ruajtjes së njohurive.

U përgatit **anketë për nevojat e vlerësimit** që u shpërnda në mënyrë që të bëhet identifikimi, planifikimi dhe shprehja e interesit për nevojat e OJQ-ve lokale dhe mediave për aktivitete për ndërtim të kapaciteteve brenda sektorit të zbulimit dhe sigurisë. Kjo anketë u inicua për të përcaktuar interesin dhe kapacitetin për tu

angazhuar në mënyrë më efektive me aktivitete për informim më të mirë të opinionit lidhur me statusin dhe progresin në fushën e qeverisjes së zbulimit dhe sigurisë dhe llogaridhënies në Maqedoninë e Veriut. Kjo anketë do i mundësojë ekipit të DCAF-it baza më të mira njohurish lidhur me atë se si të rritet bashkëpunimi dhe trajnimet në të ardhmen.

AKTIVITETET E ARDHSHME

PRILL 2022

- Analizë e Zbrazëtirave në zbatimin dhe dispozitat e Ligjit për Agjencinë Kombëtare të Sigurisë (AKS) dhe Ligjit për koordinim të komunitetit të sigurisë dhe zbulimit.
- Konsultim me agjencitë që zbatojnë ligjin dhe gjyqësorin mbi sfidat dhe zbrazëtirat gjatë përdorimit të Masave të Posaçme Hetimore (MPH)
- Ndihma ndaj Sektorit të Mjeksisë Ligjore brenda MPB për përgatitje të Planit të Veprimit për aktivitete të zbatuara për Forcim të Procesimit dhe Këmbimit të Automatizuar të të Dhënave ADN
- Punëtori mbi Rregulloren e Punës (RRP) për përdorim të Dhomës së Izoluar

MAJ 2022

- Përgatitje dhe transmetim i debatit televiziv në TV Alsat me temë "Digjitalizimi dhe reforma në sektorin e zbulimit dhe sigurisë" në bashkëpunim me 360 shkallë
- Punëtorja Udhëzuese TT # 4 për ekspertët gjyqësorë dhe ligjorë: Nga teoria në praktikë - Avancimi i praktikës gjyqësore lidhur me mbikëqyrjen e Masave të Posaçme Hetimore (MPH) me përdorim të Metodave për Nxënie dhe Ruajtje të Njohurive, në Berovë
- Nënshkrimi i Memorandumit të ri për Bashkëpunim me Qeverinë dhe Marrëveshjeve për Bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Drejtorinë për Siguri të Informatave të Klasifikuara (tk)
- Sesione trajnimi për forcim të integritetit të punonjësve të MPB
- Mini-dokumentar mbi zbatimin e Ligjit për ndjekje të komunikimeve
- Mbështetja e Sektorit të Mjeksisë Ligjore brenda MPB në hartimin e Procedurave për Regjistrime Penale dhe Teknike dhe Identifikim të Personave dhe Trupave të Panjohur të Pajetë
- Diskutime me grupe nominale përmes ushtrimeve me skenare në bashkëpunim me OJQ, C3Initiative

QERSHOR 2022

- Tavolinë e rrumbullakët mbi rolin e Kuvendit në qeverisjen me zbulimin, Gjenevë, Zvicër (datat tk)
- Trajnim mbi Mbikëqyrjen qytetare dhe qeverisjen e mirë të sektorit të sigurisë për OJQ-të dhe Mediat, Ohër, Maqedoni e Veriut (tk)
- Trajnim për ekspertët e mjekësisë ligjore mbi kohëzgjatimin Ndërkombëtar të ADN-së
- Hartimi dhe botimi i Katalogut/Brosurës së shërbimeve mbi shërbimet e MPB-së të mjekësisë ligjore
- Takimi i Eurotalk (nën Rregullat e Chathamit) në bashkëpunim me OJQ EUROTHINK